

VENDIM
Nr. 93, datë 6.4.2021

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “GERTI” SHPK, PËR ZGJATJEN E AFATIT TË
VENDIMMARRJES SË ERE-s PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GERTI” SHPK,
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“VARDARI” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1972 kw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 40/5 prot., datë 1.4.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të vendimarrjes së ERE-s për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 10, datë 20.1.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendndodhje në Përroin e Vardarit dhe të Valit, degë e Përroit të Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan.

- Në mbledhjen e Bordit të datës 22.2.2021 u relatua relacioni nr. 30/3, datë 16.2.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Vardari” me kapacitet të instaluar 1972 kw”.

- Nga ana e Bordit të ERE-s u konstatua nevoja e kërimit të informacionit, në lidhje me përthithjen e të drejtave të shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., nga “Gerti” sh.p.k., në vijim të “Amendim kontrate” nr. 1818 rep. dhe nr. 388/2 kol., datë 24.12.2020, “Për kontratën e ndërtimit, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Vardari’ me kapacitet 1.972 mw, në përroin e Vardarit dhe të Valit, degë e Përroit të Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan”, me anë të së cilës të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., i janë transferuar shoqërisë “Gerti” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 58, datë 22.2.2021, vendosi të zgjasë me 30 ditë punë afatin e vendimarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për dokumentimin nga aplikuesi, në lidhje me sa konstatuar më lart.

- Në vijim të kësaj vendimarrjeje ERE i është drejtuar shoqërisë “Gerti” sh.p.k., me shkresën nr. 405 prot., datë 2.3.2021, me anë të së cilës i kërkoi depozitimin e dokumentacionit që vërteton kryerjen e transferimit të lejes së ndërtimit nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria “Gerti” sh.p.k.; Dokumentacionin që vërteton kryerjen e transferimit të lejes mjedisore nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria “Gerti” sh.p.k.; Kontratën e qirasë të lidhur midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe Bashkisë Librazhd, “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik, ndërtim dhe shfrytëzim HEC Vardari”, me palën qiramarrëse të zëvendësuar; “Marrëveshjen e lidhjes së re” të nënshkruar midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe OSHEE sh.a., me palën e zëvendësuar; Dokumentacionin që vërteton transferimin e aseteve nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria “Gerti” sh.p.k., si dhe bilancin e çeljes për veprimtarinë e shfrytëzimit dhe të administrimit të hidrocentralit “Vardari” me kapacitet 1.972 mw.

- Duke qenë se nga ana e shoqërisë nuk kishte asnjë përgjigje, ERE iu drejtua sërish me shkresën nr. 405/1 prot., datë 24.3.2021, duke i kujtuar edhe njëherë detyrimin për të përcjellë në ERE sa më sipër.

- Ndërkohë, përpara përfundimit të afatit të caktuar nga Bordi, me vendimin nr. 58/2021, shoqëria “Gerti” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 405/2 prot., datë 30.3.2021, ka kërkuar shtyrjen e afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s për paraqitjen e dokumentacionit të lëshuar nga institucionet përkatëse, pasi nuk janë siguruar ende (varen nga vendimet e institucioneve respektive), edhe pse kjo e fundit ka aplikuar në kohë për ndryshimin e emrit të subjektit, sipas kërkesave dhe sipas saj kjo e drejtë sigurohet nga kontrata e transferimit të të drejtave me MIE-n.

- Kërkesa e “Gerti” sh.p.k. rezulton e depozituar brenda afatit të përcaktuar në nenin 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, i cili përcakton se:

3. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.

- Ndodhur në të tilla rrethana, kur shoqëria jo për fajin e saj, nuk ka mundur të sigurojë dokumentacionin e kërkuar, vlerësojmë/sugjerojmë shtyrjen me 30 ditë pune të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s, në mënyrë që t’i jepet shoqërisë “Gerti” sh.p.k. mundësia për t’u pajisur me këto dokumente dhe t’i depozitojë ato në ERE.

Për gjithë sa me sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 60 ditë punë afatin e vendimmarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Shoqëria “Gerti” sh.p.k. të paraqesë brenda 30 ditëve pune nga njoftimi i këtij vendimi:

a) dokumentacionin që vërteton kryerjen e transferimit të lejes së ndërtimit nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria “Gerti” sh.p.k.;

b) dokumentacionin që vërteton kryerjen e transferimet të lejes mjedisore nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria “Gerti” sh.p.k.;

c) kontratën e qirasë të lidhur midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., dhe Bashkisë Librazhd, “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik, ndërtim dhe shfrytëzim HEC Vardari”, me palën qiramarrëse të zëvendësuar;

d) “Marrëveshjen e lidhjes së re” të nënshkruar midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe OSHEE sh.a. me palën e zëvendësuar;

e) dokumentacionin që vërteton transferimin e aseteve nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria “Gerti” sh.p.k., si dhe bilancin e çeljes për veprimtarinë e shfrytëzimit dhe administrimit të hidrocentralit “Vardari” me kapacitet 1.972 mw.

3. Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti